



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 626 Prot.

Tiranë, më datë 06.12.2024

VENDIM
Nr. 526, datë 06.12.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, VKM Nr.793, datë. 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kriterëve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.12.2024:

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e kërkesës së subjektit “**SALILLARI**” sh.p.k. për paisje me licencë në veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore me drejtues teknik **Z. Skënder Bushi** në nënkategoritë: **A1.Vëzhgim arkeologjik; A2.Sondazhe arkeologjike; A3.Gërmime arkeologjike**;; pasi nuk plotëson kriteret për pajisjen me licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për personin juridik sipas Nenit 4, pika 5, gërma b) të Vkm 793, datë 7/10/2020:
b) “të ketë të paktën 5 vjet përvojë si person juridik në veprimtarinë kryesore hulumtimet arkeologjike dhe/ose arkeologjike nënujore”;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

KRYETAR
Blendi GONXHJA